



KOMUNA GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	24 1081		20 23
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01-	42171	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Data/Date: 11 gusht 2023

Nga/Od/From: Grupi Punues për Hartimin e Programit Komunal Tre Vjeçar të Banimit 2023-2025
Për/Za/To: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit, Milaim Hajdari
CC: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit
Tema/Subjekat/Subject: Procesverbali nga procesi i dëgjimit të parë publik për Hartimin e Programit Komunal Tre Vjeçar të Banimit 2023-2025

P R O C E S V E R B A L

i dëgjimit të parë publik për: Hartimin e Programit Komunal Tre Vjeçar të Banimit 2023-2025

Pas themelimit të Grupit Punues për Hartimin e Programit Komunal Tre Vjeçar të Banimit 2023-2025, sipas vendimit të kryetarit nr. 01-020/04-6514, i datës: 02.02.2023, dhe ftesës për pjesëmarrje në takim lidhur **organizimin e konsultimit me punlikun** nr. 01-020/03-36761 dt 28.07.2023 , linqet në ueb-faqe të komunës: <https://kk.rks-gov.netgllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/07/Draf-Programi-Trevjeçar-i-banimit-social.pdf>; si dhe linku në Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas> u mbajt takimi i parë publik.

P R O C E S V E R B A L

Vendi i takimit	Data	Ora
-----------------	------	-----



Takimi lidhur me dëgjimin e parë publik për Programin Komunal Tre Vjeçar të Banimit 2023-2025, është hapur nga udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, u mbajt më 11.07.2023, në orën 11:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në takim, përveç bartësve përgjegjës, në përbërje nga: Grupi Punues, qenë të pranishëm edhe, përfaqësues të fshatrave, lagjeve si dhe shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e banimit social.

Udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim

Dobra, duke e hapur takimin i përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe ndër tjerash tha: të nderuar qytetarë të komunës së Drenasit, faleminderit që keni gjetur kohë për pjesëmarrje në këtë takim, ai theksoi se Komuna Drenasit me kohë ka bërë njoftimin publik ku të gjithë qytetarët kishin të drejtë të japin ide, sygjerime dhe



rekomandimet e tyre si dhe përmes e-mail adresave të cilat ishin të shpallura në thirrje punlike.

Fjalën e jap kryesuesit të grupit punues si dhe përfaqësuesit të Drejtorisë së Shëndetësisë e cila do e bëjë prezantimin e përmbajtjes së këtij plani komunal tre vjeçar të banimit.

Lumturije Kiqina duke falenderuar të pranishmit për pjesëmarrje filloi me prezantimin e programit tre vjeçar të banimit, prezentimi i grupit punues, objektivat, qëllimi i programit, vizioni, kategoritë të cilat mund të përfitojnë nga ky progra, kriteret, përparësitë, planifikimet në të ardhmen, kërkesat e vitit të kaluar për banim social. E gjithë prezentimi u përmbyll me citimin se e drejta për banim është kusht elementar i jetës e garantuar me ligj, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht lus që kur ta merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.



Fjalën e mori **Izet Bytyqi**, administrator nga fshati **Fushticë**, i falenderoj të pranishmit dhe pyetjen që e parashtrroi ishte se qytetarët të cilët nuk kanë banim ku duhet të lajmërohen fillimisht për këtë a duhet të lajmërohen tek ne (administratorët e fshatrave) që të kenë sa më të lehtë aplikimin.

Lumturije Kiqina u përgjigj se e gjithë procedura bëhet përmes Thirrje Publike çdo dy vite, sepse siç e dini kontrata e shfrytëzuesve të banimit social janë në periudhë dy vjeçare, andaj çdo dy vite ka shpallje publike të cilën mund të aplikojnë gjithë ata të cilët kanë nevojë për banim.

Bekim Dobra – për plotësim të **Lumturijes** theksoj se tani jemi në procedurë për rregullim të dokumentacionit për ndërtimin e blloqeve të bimit social, jemi në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë përkatëse.

Murat Elshani, administrator i fshatit Gllobar: Përsëritet për të gjithë. Ndoshta jam jashtë rendit të ditës mirëpo kisha kërkuar nga komuna e Drenasit se a ka paraparë diçka për pensionistet ndonjë qëndrim ditor, si dhe kategoritë të cilat kanë nevojë për banim ndoshta ishte dashur të njoftohen më për së afërmi nga zyrtarët e DSHMS-së, pasi që nuk janë të njoftuar sa duhet ose të na dërgojnë ne (administratorëve) ndonjë njoftim apo strategji për njoftimin e banorëve.

Bekim Dobra – *i nderuar javën e ardhshme është dëgjimi publik me qytetarët dhe ne do ta diskutojmë edhe këto tema dhe realitetin se sa ka buxhet Komuna për këtë qështje.*

Metodat e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuar
Takimi i drejtpërdrejtë me qytetarët e komunës së Drenasit të organizuar nga grupi punues për Hartimin e planit	11.08.2023 11:00-12:00	29	2	



komunal tre vjeçar të banimit				
-------------------------------	--	--	--	--

* Derisa Plani Komunal Tre Vjeçar i Banimit ishte në procesin e konsultimit, kërkesat në formën elektronike nuk janë pranuar.

Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim:

Nëse dikush tjetër nuk ka për të shtuar diçka, apo ndonjë kërkesë, duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, takimi i sotëm përfundon këtu!

Me kaq takimi mori fund në orën 12:00.

Dokumentet e bashkëngjitura:

Ftesa për pjesëmarrje;

Lista e pjesëmarrësve;

Procesmbajtësi

Arlinda Thaqi

Zyrtare për Mirënjohje Sociale

